

VENDIM
Nr.306, datë 28.1.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “RADIO 7”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë“, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.032/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulën në frekuencë, subjektin “Media J-7” sh.p.k. për “Radio 7”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi të mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 6.11.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj